



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCC-10-0278

*Paditësit:*

A H dhe M H, nga M, të cilët i përfaqëson Av Rr K nga M.

Kundër

*Të paditura:*

O “M” në Malishevë, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP),  
Dritan Hoxha nr.55, Lakrishte, Prishtinë dhe Komuna e Malishevës – Malishevë.

Rr.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues, Hajrie Shala dhe Diellza Hoxha, gjyqtare, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 05 janar 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadi e paditësve A H dhe M H, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet sa ata janë pronar të ngastrës kadastrale nr.8, në vendin e quajtur “Rr”, me sipërfaqe për 0.82.24 ha, fleta poseduese nr.87, ZK M.**
- II. Paditësit e kanë paguar taksen gjyqësore për padi, andaj nuk ngarkohen me taksë shtesë.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 25 tetor 2006, përfaqësuesi i paditësve ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Malishevë. Paditësit kërkojnë vërtetimin e të drejtës së pronësisë për ngastrën kadastrale nr. 8, në vendin e quajtur “Rr”, me sipërfaqe për 0.82.24 ha, fleta poseduese nr.87, ZK Malishevë. Ata pohojnë se janë trashëgimtarë të trashëgimlënësit D A H dhe për këtë i kanë ofruar gjykatës aktvendimin për trashëgimi T.nr.8/2006 të dt. 12 shkurt 2008. Sipas paditësve paraardhësi i tyre ishte pronar i ngastrës së lartpërmendur deri sa në vitet e 60’ta kur edhe i ishte marre prona, njëjtë sikurse dhe qytetareve tjerë nga organet e atëhershme shtetërore dhe i ishte bashkuar ndërmarrjes bujqësore O “M” dhe kjo ishte bërë pa kurrfarë kompensimi.

Paditësit pretendojnë se të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese, në një formë ja ka njohur edhe KK-Malishevës me 29 shtator 2003, duke lidhur me paditësit kontratë mbi dhënien e tokës

bujqësore në shfrytëzim të përkohshëm. I kanë propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e tyre ta aprovoj si të bazuar.

Pas mbajtjes së disa seancave me 12 gusht 2010, Gjykata Komunale në Malisheve me Aktvendimin C.nr.258/2006 e ka shpall veten jo kompetente për të vendosur në çështjen juridike të paditësve, ashtu që përmes parashtresës së datës 29 shtator 2010, dosjen e lëndës e ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ( tutje shkurtesa DHPGJS).

Me 01 nëntor 2010, gjykata ka lëshuar një urdhër për përfaqësuesin e paditësve dhe ka kërkuar nga paditësit të sjellin prova dhe dëshmi për të mbështetur kërkesëpadinë.

Me 03 mars 2017, përfaqësuesja e paditurës AKP ka ushtruar mbrojtje në padi dhe e ka kundërshtuar në tersi padinë e paditësve dhe pretendimet e paditësve si të pabazuara. Ka shtuar se paditësit nuk kanë theksuar bazën juridike me të cilën mbështet kërkesëpadija si dhe nuk kanë dhënë shpjegime dhe sqarime të mjaftueshme se me çfarë baze juridike paraardhësi i paditësve e ka humbur pronën kontestuese. AKP tutje ka shtuar se pretendimet e paditësve se nga viti 2003, e kanë ri poseduar pronën mbi bazën e kontratës së qirasë, nuk është bazë ligjore përmes se cilës mund ti njihet e drejta e pronësisë paditësve, meqë kjo kontratë ka qenë me afat të caktuar kohor dhe nuk mund të shërbejë si burim për të drejtën e pretenduar. AKP i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë e paditësve si të pabazuar.

Me 14 prill 2017, përfaqësuesi i paditësve ka parashtruar përgjigje në mbrojtje të paditurës duke shtuar se në tersi e kundërshton mbrojtjen e paditurës dhe se qëndron pranë padisë se tij lidhur me vërtetimin e pronësisë. Paditësit si provë kanë bashkangjitur:

- Certifikatën e vdekjen për D H lëshuar me dt.20.10.2006.
- Aktvdekjen i dt. 20.10.2006.
- Certifikatën mbi të drejtën e pronës se pabujshme i dt. 29.09.2006 ( pronar është O M)
- Kontratën mbi dhënien e tokës në shfrytëzim të përkohshëm 29.09.2003
- Ekspertize e dt. 04.10.2007.
- Një skice të kopjes së planit.
- Aktvendimin e trashëgimisë T.nr.8/2006 i dt. 12.02.2008.
- Historiatin e dt. 26 nëntor 2022 të bërë nga M G G SH. ( kompani gjeodete e angazhuara nga vet paditësit).

Me 07 dhjetor 2022, gjykata mbajti seancë dëgjimore, ku përfaqësuesi i paditësve në fjalën e tij deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë të ushtruar pranë kësaj gjykate dhe parashtresave tjera. Përfaqësuesi i paditësve ka përsëritur pretendimin se paraardhësit të paditësve i është i marr toka pa kurrfarë përgjegjësie. Ka shtuar se pas luftës prona kontestuese i është dhen paditësve më shfrytëzim me qira mbi bazën se toka në fjalë ishte e paraardhësit të tyre. Pretendon se prona në fjalë ishte bartur tek e paditura pas shumë ndërrimeve të pronarëve të ndryshëm-ndërmarrjeve të shumta bujqësore dhe se paditësit janë tërësisht të njohur se atyre asnjëherë nuk i është bërë kompensimi. Paditësit janë në shfrytëzim të kësaj prone, ndërsa me kontratë për

shfrytëzimin që është dhënë vazhdojnë ta posedojnë pa asnjë pengesë. I kanë propozuar gjykatës që të aprovoj padinë e tyre në tërësi si të bazuar.

Edhe përfaqësuesi i AKP-së në seancën dëgjimore dhe në fjalën e saj ka deklaruar se qëndron pranë mbrojtjes së paraqitur në Dhomën e Posaçme. Ka theksuar se kërkesën e paditësve e kundërshtojnë si të pa bazuar dhe kërkon nga gjykata që ta refuzoj padinë e paditësve si të pabazuar. Ka shtuar se sipas shkresave të lëndës paditësit nuk kanë prezantuar faktet materiale që kanë të bëjnë me padinë, e sidomos nuk kanë prezantuar argumentet ligjore në të cilat mbështetet kërkesëpadia. Kjo, nga fakti se paditësit e kanë barrën e të provuarit të drejtës, në kuptim të nenit 7 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Ligji nr. 03/L-006. Paditësve në procedurën administrative nga AL, kërkesa pronësore iu është refuzuar në mungesë të provave të besueshme materiale, përkatësisht konfiskimit arbitrare viteve të 60-ta, shfrytëzimit të pronës. Provë: Vendimi i AL nr. PRZ008-1619 e dt.13.3.2015. Pretendimet e paditësit se është bere pronare mbi bazë të kontratës mbi qiranë një vjeçare e lidhur në vitin 2003, është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të cilat rregulloj këtë fakt, sepse, kontrata mbi qiranë nuk është dokument për vërtetim e pronësisë e cila do të shërbente për realizimin e të drejtës së pretenduar.

Paditësit pretendojnë se prona kontestuese që nga viti 1960 iu është marr pa bazë ligjore. Në padi nuk ka theksuar asgjë rreth asaj se a ka kërkuar ndonjëherë paraardhësi i paditësve pronën kontestuese deri me parashtrimin e padisë. Nga kjo rrjedhë konkludimi se paditësit kanë qenë pasive dhe të pa interesuar në drejtim të fitimit të së drejtës së pronësisë mbi ngastrën kadastrale kontestuese, nga se asnjëherë nuk ka ndërmarrë veprime ligjore për realizimin e asaj të drejte në atë kohë. Andaj, me faktet të cilat i kanë paraqitur paditësit në këtë çështje dhe me dëshmitë që ia kanë bashkangjitur kërkesëpadiës, nuk ka arritur të dëshmoj se ata janë pronar i ngastrave kadastrale që janë objekt kontesti. Gjithashtu nga padia e parashtruar nuk mund të kuptohet se nga cila ka qene baze juridike e humbjes së pronësisë së paditësi pasi që LMTHPJ në mënyre taksative në kapitullin e pushimit të pronësisë përcakton kushtet e pushimit të drejtës së pronësisë (Neni 44-48). Bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Nuk kemi nevojë për historiat sepse është bere ekspertiza me herët dhe ekziston në shkresa të lëndës. Nga të gjitha këto që u parashtruan më lartë, rezulton se nuk qëndrojnë thëniet e parashtruara nga ana e palës paditëse, këto thënie kanë mbetur vetëm në nivel të pretendimeve dhe si e tillë padia duhet të refuzuar si të pa bazuara.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

### **Arsyvetimi Ligjor**

Kolegji gjykues i Dhomës së Posaçme, pas shqyrtimit të përgjithshëm të padisë, dokumenteve të bashkangjitura dhe provave të mbledhura gjatë procedurës me shkrim, administrimit të tyre, vjen në përfundim se padia është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Paditësit nuk ka ofruar dëshmi relevante për të vërtetuar faktin se atyre u takon e drejta e pretenduar. Paditësit kanë dështuar që para gjykatës të ofrojë dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tyre se ngastra kadastrale nr. 8, i është marr paraardhësit të paditëseve me dhunë apo forma të tjera siç pohojnë ata nga pushteti i atëhershëm. Pohimi i paditësve se prona kontestuese në vitin 1958 ka qenë e evidentuar në emër të paraardhësit të tyre sipas gjykatës nuk është provë e mjaftueshme për ti bërë ata pronar. Para gjykatës ata kanë dështuar të provojnë se në çfarë mënyre apo forme janë zhveshur nga e drejta e pronësisë. Madje në këtë aspekt e paditura është në situatë më të favorshëm kur thirret në ata se që nga ajo kohë është pronare e paluajtshmerisë në fjalë dhe nuk është penguar nga askush.

Paditësit pretendimin e tyre e bazojnë në Ekspertizën nr.C.nr.2586/06, të datës 04 tetor 2007. Ekspertiza në fjalë përshkruan gjendjen dhe historiatin e ngastrës në periudha të ndryshme, ku vërehet se prona kontestuese me rastin e aerofotografimit në vitin 1958 ka qenë e evidentuar në emër të paraardhësit të tyre. Me pas kjo ngastër fshihet nga regjistri sipas regjistrimit të ankesave dhe pastaj disa herë bëhet ndërrimi i titullarit të kësaj pronë ku tani e fundit është pronare O M. Pra nisur nga kjo kronologji shihet se prona kontestuese ka bërë disa ndërrime të titullarëve deri tek e paditura O M, prandaj pretendimi i paditësve për të kërkuar kthimin e pronës ndaj të paditurës duke u bazuar në një konstatim të tillë është i pabazuar. Gjykata vëren se edhe Historiati i dt. 26 nëntor 2022 i bërë nga M G G SH.( kompani gjeodete e angazhuara nga vet paditësit), i dorëzuar nga paditësit në seancën dëgjimore përshkruan gjendjen e njëjtë siç është përshkruar edhe tek ekspertiza e datës 04 tetor 2007, prandaj nuk ka nevojë të elaborohet.

Paditësit pretendojnë se atyre nuk i është bërë kurrfarë kompensimi, deri sa në anën tjetër siç thamë me lart nuk i kanë provuar para gjykatës se në çfarë forma ata janë zhveshur nga e drejta e tyre e

pronësisë. Po ashtu pretendimi i paditësve se ata e shfrytëzojnë dhe e posedojnë paluajtshmerin pa kurrfarë pengës, nuk u jep atyre të drejtë që ta konsiderojnë vetën pronar. Për më tepër një gjë e tillë është kundërshtuar edhe nga e paditura. Pretendimi i tillë i paditësve mund të shërbej tek forma fitimit të pronësisë me parashkrim fitues por edhe aty kërkohet të plotësohen disa kushte.

Paditësit gjithashtu e mbështesin të drejtën e fitimit të pronësisë mbi bazën e kontratës mbi qiranë një vjeçare të lidhur me 29 shtator 2003, në mes ta paraardhësit të tyre dhe Komunës si përgjegjëse për dhënien e tokës bujqësore. Edhe gjykata sikurse e paditura konsideron se kjo nuk është mënyrë e fitimit të pronësisë sepse kontrata mbi qiranë nuk është dokument për vërtetim e pronësisë e cila do të shërbente paditësve për realizmin e te drejtës se pretenduar.

Gjykata konstaton se Ndërmarrjes shoqërore si zotëruese aktuale e pronës së paluajtshme, duhet ti ofrohet siguri juridike që një e drejtë e cila nuk është kontestuar për kaq shumë vite do të mbetet e pa ndryshuara. Ky stabilitet i të drejtave pronësore meriton mbrojtje nga gjykata.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësve lidhur me të drejtën e tyre për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Paditësit kanë paguar taksen gjyqësore për padi, andaj nuk ngarkohen me taksë shtesë. Gjykata konform nenit 62.5 vendos që secila palë ti batë shpenzimet e veta.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues

Hajrie Shala, Gjyqtare

Diellza Hoxha, Gjyqtare